

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 1 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

## Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg

	Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg	PR-MO-002
	ver. 1.0	page 2 from 30
Departament: Operimi i Tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

## PËRMBAJTJA

1. QËLLIMI.....	3
2. FUSHA .....	3
3. PALËT PËRGJEGJËSE .....	4
4. PËRMBLEDHJE: REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE TË TREGUT.....	5
5. PARIMET E PROCEDURËS: REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE TË TREGUT .....	8
5.1 Dispozitat e përgjithshme.....	8
5.2 Dorëzimi i Aplikacionit për Regjistrim .....	9
5.3 Aderimi dhe Autorizimi .....	10
5.4 Marrja e Linjës së Komunikimit.....	11
5.5 Regjistrimi.....	11
6. PËRMBLEDHJE: TËRHEQJA DHE ÇREGJISTRIMI I NJË PJESËMARRËSI TË TREGUT .....	13
7. PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS: TËRHEQJA E PJESËMARRËSVE TË TREGUT .....	16
7.1 Dispozitat e përgjithshme.....	16
7.2 Tërheqja e një Pjesëmarrësi të Tregut .....	17
7.3 Dorëzimi i Njoftimit për Tërheqje .....	18
7.4 Përrjashtimi i një Pale Tregtare .....	19
7.5 Kontrolli i tërheqjes dhe Kliringu Financiar .....	20
7.6 Anulimi i Linjës së Komunikimit .....	22
7.7 Çregjistrimi .....	22
7.8 Kontrollët Përfundimtare.....	23
8. PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS: NDRYSHIMI I TË DHËNAVE KRYESORE OSE ROLIT TË PALËS .....	25
9. ANEKSET.....	26
10. DOKUMENTET/FORMULARËT .....	29

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 3 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

## 1. QËLLIMI

Në mënyrë që të zbatohen Rregullat e Tregut (tutje RrT) dhe për të mundësuar operimin eficient dhe të rregullt të tregut sipas RrT Operatori i Tregut (OT) në pajtim me Nenet 70 dhe 71 të RrT ka miratuar Procedurën Operative për Regjistrimin dhe Tërheqjen e Pjesëmarrësve të Tregut, si në vijim.

Kjo procedurë definon kërkesat për të dhëna, planin kohor dhe përgjegjësitë e palëve tregtare për pjesëmarrjen në Tregun e Energjisë Elektrike në Kosovë, nëpërmjet aderimit në RrT dhe regjistrimit zyrtar nga OT si dhe për tërheqjen nga tregu. Për më shumë, kërkesat për njoftimin zyrtar janë përcaktuar se cilat të dhëna zyrtare dhe kryesore të palëve tregtare kanë ndryshuar gjatë periudhës kur pala tregtare është aktive në tregun e energjisë elektrike.

Termet specifike të përdorura në këtë procedurë janë të definuar në një dokument të veçantë “Fjalorthi i Procedurave Operative” i cili do të dorëzohet dhe publikohet së bashku me procedurat. Termet të cilat tashmë janë të definuar në Rregullat e Tregut, Kodin e Rrjetit dhe Kodin e Matjes nuk do të definohen në Fjalorthin e Procedurës Operative.

## 2. FUSHA

Kjo procedurë mbulon rregullat dhe hapat për regjistrimin e Pjesëmarrësve të ri të Tregut të cilët aderojnë në RrT të Kosovës pas datës kur është nënshkruar Marrëveshja Kornizë. Sidoqoftë, OT rezervon të drejtën të kërkojë të dhënat e caktuara për regjistrimin e Palës, gjithashtu edhe nga palët të cilat nënshkruajnë Marrëveshjen Kornizë.

Aderimi në RrT dhe regjistrimi si Pjesëmarrës i Tregut janë parakushte për pjesëmarrje në Tregun e Energjisë Elektrike në Kosovë. Prandaj, kjo procedurë operative definon se si palët që aplikojnë për regjistrim duhet t’i qasen OT për tu regjistruar.


Pjesëmarrësit e Tregut në vijim duhet të aderojnë në RrT dhe bëhen Pjesëmarrës të Tregut, të regjistruar.

### a) Palët Tregtare;

Kjo përfshin rolet vijuese sipas kapacitetit pjesëmarrës “Palë Tregtare”:

- Furnizuesit;
- Gjeneratorët;
- Tregtarët e Interkonektuar

### b) Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes.

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 4 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

Kjo procedurë operative nuk përfshin regjistrimin e Njësive Balancuese dhe Sistemeve të Matjes. Pjesëmarrësit e Tregut të cilët dëshirojnë të regjistrojnë njësitë Balancuese duhet që së pari të zbatojnë këtë Procedurë Operative për regjistrimin e Palës dhe pastaj të zbatojnë udhëzimet e Procedurës Operative E003 Regjistrimi i Njësive Balancuese. Pjesëmarrësit e Tregut të cilët dëshirojnë të regjistrojnë Sistemet e Matjes duhet të zbatojnë procedurën për regjistrimin e Palëve, dhe pastaj të zbatojnë udhëzimet e Procedurës Operative ET002 Regjistrimi i Sistemeve Matëse/

Për më tepër, kjo procedurë operative definon se cilat janë kushtet për çregjistrimin nga Tregu i Energjisë Elektrike, qoftë me tërheqje nga Pjesëmarrësi i Tregut ose për arsye të anulimit me kërkesë të OT në pajtim me dispozitat e RrT Kapitulli III.

Përsëri, kjo procedurë operative nuk përfshin çregjistrimin e Njësive Balancuese dhe Sistemeve Matëse. Pjesëmarrësit e Tregut të cilët dëshirojnë të çregjistrojnë Njësitë balancuese duhet të zbatojnë udhëzimet e Procedurës Operative E003 Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Njësive Balancuese. Pjesëmarrësit e Tregut të cilët dëshirojnë të çregjistrojnë Sistemet e Matjes duhet të zbatojnë udhëzimet e Procedurës Operative ET002: Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemeve të matjes.


Për më tepër, dispozitat për dorëzimin e informatave për ndryshimet në të dhënat e regjistruara të Pjesëmarrësit të Tregut të ofruara (psh. detalet kontaktuese).

### **3. PALËT PËRGJEGJËSE**

#### **Operatori i Tregut:**

- Themelon dhe mirëmban Regjistrin e Tregut për Tregun e Energjisë Elektrike në Kosovë, nxjerrë këtë procedurë operative në dispozicion të të gjitha Palëve të cilat dëshirojnë të regjistrohen dhe zbaton këtë procedurë operative.
- nxjerrë këtë procedurë operative në dispozicion të të gjitha Palëve të cilat dëshirojnë të regjistrohen dhe zbaton këtë procedurë operative
- përmirëson dhe azhurnon këtë procedurë varësisht nga modifikimet e legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e energjisë elektrike.
- Pranon, shënon dhe analizon aplikacionet për regjistrim

Pranon dhe/ose refuzon aplikacionet për regjistrim, themelon dhe mirëmban Regjistrin e Tregut.

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 5 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

- Pranon njoftimin për tërheqje dhe kryen të gjitha kontrollet e nevojshme me dispozitat për tërheqje, anulim dhe çregjistrim të Pjesëmarrësve të Tregut, përkatësisht.
- Anulon Palët për arsye të shkeljes sipas RrT.
- Publikon Pjesëmarrësit e Tregut të regjistruar me sukses dhe/ose të çregjistruar.

#### **Pjesëmarrësi i Tregut :**

- Aplikon për regjistrim sipas kësaj procedure operative dhe dorëzon të gjitha të dhënat e nevojshme për regjistrimin në OT dhe/ose Operator të Sistemit (OS).
- Dërgon njoftimin e tërheqjes dhe çregjistrimit.
- Dorëzon njoftimin e Anulimit, ose pranon Anulimin nga OT në rast të çregjistrimit për arsye të shkeljes sipas RrT.


#### **Operatori i Sistemit:**

- Ofron mbështetje për testet e nevojshme të linjave të komunikimit.
- Konfirmon/refuzon testet e suksesshme të linjave të komunikimit për Pjesëmarrësit e Tregut dhe OT.
- Mbështet testet e nevojshme për anulimin e linjave të komunikimit.
- Konfirmon/refuzon anulimin e suksesshëm të linjave të komunikimit.
- Me kërkesë të OT konfirmon shkyçja teknike e anulimit të Sistemeve të matjes ose Njësiye Balancuese është kaluar me sukses.

## **4. PËRMBLEDHJE: REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE TË TREGUT**

Kapitulli vijues shkurtimisht përshkruan cilët hapa të regjistrimit duhet të ndjekin Palët Tregtare të cilat aplikojnë për pjesëmarrje në tregun e energjisë elektrike – varësisht nga roli i tyre në treg. Më vonë, dmth në procedurë do të definohet,

1. Cilët hapa duhet të ndërmerren nga palët të cilat aplikojnë për regjistrim në tregun e energjisë elektrike në Kosovë.
2. Cilat të dhëna dhe dokumente zyrtare duhet të dorëzohen dhe në cilën kohë.
3. Të cilat autorizime janë të nevojshme;

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 6 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

4. Cilat shkëmbime të të dhënave ndërmjet palëve dhe aplikantëve dhe OT janë të nevojshme në mënyrë që si duhet të regjistrohet Pjesëmarrësi i Tregut.

Procesi i Hyrjes në Treg mbulon hapat vijues:

- Dorëzimi i Formës së Aderimit;
- Aderimi dhe Autorizimi;
- Marrja e Linjës së Komunikimit; dhe
- Regjistrimi.

Këta hapa janë definuar detajisht në kapitullin 5.

Të gjithë Pjesëmarrësit e Tregut të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në Tregun e Energjisë Elektrike në Kosovë në një ose më shumë nga rolet vijuese:

1. Furnizuesit
2. Gjeneratorët
3. Tregtarët
4. Tregtarët Interkonektiv
5. Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes

Aderojnë në RrT dhe në shumicën e rasteve kanë një licencë të caktuar (Furnizuesit/Tregtarët dhe Gjeneratorët) para se mund të fillojnë tregtimin. Licencat jepen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRÉ).

Palët të cilat regjistrohen si Furnizues gjithashtu duhet të azhurnojnë regjistrimin e Sistemeve Matëse të tyre nëpërmjet ET002 Regjistrimi i Sistemeve Matëse. Pjesëmarrësit duhet të kontaktojnë OT për të diskutuar kërkesat për regjistrim.

Gjeneratorët gjithashtu duhet të regjistrojnë Njësitë Balancuese të tyre (referohu Procedura Operative E003 Regjistrimi i Njërive Balancuese dhe Sistemeve Matëse (referohu Procedura Operative ET002 Regjistrimi i Sistemeve Matëse).

Tabela vijuese jep një pasqyrim të shkurtë për planin kohor përkatësisht dokumentet input - dhe output për regjistrimin e Pjesëmarrësit të Tregut.

Veprimet/Dokumentet	Pjesëmarrësi i Tregut D- Dërgon P-Pranon	OT D- Dërgon	SO D- Dërgon	Plani Kohor Së paku x ditë para Datës Efektive



Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve  
në treg

PR-MO-002


ver. 1.0

page 7 from 30

Departament: Operimi i Tregut

Sektori: Menaxhimi i Kodit

		P-Pranon	P=Pranon	
Dorëzimi i Formës së Regjistrimit të plotësuar	D	P		30
Dërgimi i Marrëveshjes së Aderimit	P	D		20
Dorëzimi i Marrëveshjes së Aderimit të Nënshkruar	D	P		15
Kërkesa e linjës së komunikimit	D		P	25
Konfirmimi i lidhjes së linjës së komunikimit	P	P	D	5
Konfirmimi i regjistrimit të suksesshëm si Pjesëmarrës i Tregut	P	D	P	2

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 8 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>


## **5. PARIMET E PROCEDURËS: REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE TË TREGUT**

### **5.1 Dispozitat e përgjithshme**

- a) Të gjitha dispozitat e kësaj Procedure Operative i kushtohen regjistrimit të Pjesëmarrësve të Tregut të cilët aderojnë në RrT të Kosovës, pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë. Sidoqoftë OT rezervon të drejtën të kërkoj të dhëna të caktuara për regjistrimin e Palës, gjithashtu edhe nga palët të cilat nënshkruajnë Marrëveshjen Kornizë.
- b) OT do të themeloj funksionin e regjistrimit në mënyrë që të përmbush obligimet e veta të përcaktuara në RrT lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërlidhura me regjistrimin edhe çregjistrimin e pjesëmarrësve të Tregut.
- c) Ky funksion i regjistrimit do të përmbushet nga zyra përgjegjëse EIC (Energy Identification Code-Kodi Identifikues Energjetik) e themeluar në zyret e OT sipas kërkesave të regjistrimit të ETSO.<sup>1</sup>
- d) Themelimi dhe mirëmbajtja e Regjistrimit të Tregut do të jetë në pajtim me kërkesat për Regjistrimin e Palëve Tregtare të nxjerra nga ETSO. OT do të jetë përgjegjës për regjistrimin edhe caktimin e EIC për Pjesëmarrësit e Tregut të Kosovës.
- e) OT kohë pas kohe përcaktoj taksën e aplikimit të pagueshme nga Pjesëmarrësit e Tregut në lidhje me aplikimin për aderim si palë e RrT. Kjo taksë e aplikimit duhet të miratohet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë).
- f) Vlera e taksës së aplikimit duhet të publikohet në ueb faqen e OT.
- g) Taksa e Aplikimit nuk duhet të tejkaloj shumën e cila sipas mendimit të OT (në kohën e përcaktimit të taksës së tillë) përfaqëson koston mesatare të arsyeshme të OT për procesimin e një aplikacioni për aderim si palë e RrT.
- h) Taksa e Aplikimit e paguar nga një Pjesëmarrës i Tregut nuk do t'i refundohet atij Pjesëmarrësi të Tregut për çfarëdo arsye.
- i) Secili Pjesëmarrës i Tregut duhet të paguaj Taksën e Aplikimit OT-së.
- j) Sipas kërkesës së OT Palët Tregtare duhet të demonstrojnë se ato kanë Mbulesë Kreditore të përshtatshme.

<sup>1</sup> Për më shumë informata ju lutem referohuni dokumentit: „Një skemë e përgjithshme e Identifikimit Energjetik për industrinë elektrike – Skema Identifikuese e Kodimit Energjetik të ETSO “ e cila mund të shkarkohet nga [www.edi.etso.org](http://www.edi.etso.org).




	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 9 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

- k) OT do të vendosë nëse pala aplikuese duhet të ofroj një certifikatë se një shumë e mjaftueshme e garancionit financiar është ofruar nga një bankë komerciale.


## 5.2 Dorëzimi i Aplikacionit për Regjistrim

- l) Secila Palë duhet të regjistrohet dhe të sigurohet të mbetet e regjistruar në Regjistrin e Tregut në pajtim me këtë paragraf.
- m) Një Palë duhet të regjistrohet në Regjistrin e Tregut me cilindo kapacitet pjesëmarrës të cilin mund ta ketë, para se me atë kapacitetet:
- (a) të regjistrohet si Sistem Matës ose Njësi Balancuese;
- (b) merr çfarëdo hapi ose veprimi tjetër sipas RrT për Sistemin Matës ose Njësinë Balancuese .
- n) Para ose paralelisht me aplikimin për regjistrim Pala aplikuese duhet t'i dëshmoj OT se ka licencën e nevojshme si kërkohet me ligjin e aplikueshëm në Kosovë.
- o) Pjesëmarrësi i Tregut i cili ka aplikuar të aderoj në RrT mund të aplikoj jo më vonë se 30 ditë para Prej Datës Efektive për regjistrimin e rolit përkatës në Regjistrin e Tregut.
- p) Për qëllim të RrT “Të Dhënat e Regjistrimit të Palës” të një pale janë:
- (a) emri i saj dhe detajet kontaktuese;
- (b) kapaciteti pjesëmarrës (nëse ka) të cilin (në kohën e regjistrimit në RrT ose një përmirësim i saj) e ka ose pret ta ketë, dhe datën me efekt prej të cilës ka ose pret të ketë kapacitetin e tillë pjesëmarrës;
- (c) qoftë se mban, dëshiron ose kërkohet (sipas Nenit 11 të RrT të mbaj Llogari të Energjisë;
- q) Regjistrimi i një Pale nuk do të bëhet efektiv derisa Pala e tillë të jetë në pajtueshmëri me kërkesat në Seksionin 0.

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 10 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

### 5.3 Aderimi dhe Autorizimi

- r) Të gjithë Pjesëmarrësit e Tregut duhet të regjistrojnë nënshkruesit e autorizuar në pajtim me s). Kjo përfshinë kompletimin e seksioneve relevante në formën e Aplikacionit për Aderim (referenca 9.1.2).
- s) Pala përgjegjëse dhe zëvendësi duhet të janë të autorizuar dhe duhet të mbulojnë çështjet vijuese:
- A: - Regjistrimi i Palës  
B:- Ndryshimi i Autorizimit  
C:- Tërheqja e Palës  
D:- Shqyrtimi i të Dhënave të Matjeve / Kontesti  
E: - Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Njësive Balancuese  
F: - Dhënia e Aplikacione për Matje  
G:- Transferi i Sistemeve Matese  
H:- Dërgimi i Raporteve të gjitha Palëve
- t) Pas pranimit të njësive të përmendura në seksionin 0 OT sa më parë që është arsyeshëm praktike por jo më vonë se 20 ditë para Regjistrimit me datë:
- (a) kontrolloj se aplikacioni është kompletuar si duhet nga Pjesëmarrësi i Tregut dhe se dokumentacioni mbështetës relevant dhe Taksa e Aplikimit janë paraqitur;
- (b) njoftoj:
- (i) Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) dhe  
(ii) secilën palë
- Për emrin e Pjesëmarrësit të Tregut dhe kapacitetet pjesëmarrëse (nëse ka) të njoftuara nga Pjesëmarrësi i Tregut në Detalet e Palës; dhe
- (c) përgatis Marrëveshjen për Aderim për Pjesëmarrësin e Tregut dhe atë t'i ja dërgoj atij Pjesëmarrësi të Tregut për ekzekutim.
- u) Aderimi i një Pjesëmarrësi të Tregut në RrT duhet të jetë efektiv me dhe nga data e Marrëveshjes së Aderimit, e cila duhet të jetë në pajtim me para data Efektive Nga e kërkuar nga Pjesëmarrësi i Tregut. Nëse nuk është e mundur të aderoj në RrT deri me datën Efektive Nga të kërkuar nga Pjesëmarrësi i Tregut OT duhet të përdor datën e ardhshme të mundshme.
- v) Pjesëmarrësi i Tregut do të nënshkruaj Marrëveshjen për Aderim dhe do të dërgoj një kopje prapë në OT duke konfirmuar tërësinë dhe saktësinë

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 11 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

e të dhënave të regjistrimit. Kjo duhet të bëhet me shkrim dhe dërgohet me e-mail dhe postë jo më vonë se 15 ditë para datës Efektive Nga.


- w) Pjesëmarrësi i Tregut me këtë pakthyeshem dhe pa kusht autorizon OT të ekzekutoj dhe dërgoj në emër të Palës së tillë një Marrëveshje të Aderimit të ekzekutuar si duhet nga Pjesëmarrësi i Tregut, dhe të pranoj Palën Aplikuese si Pjesëmarrës të Tregut në Tregun e Energjisë Elektrike në Kosovë.

#### 5.4 Marrja e Linjës së Komunikimit

- x) Të gjitha palët tregtare të cilat dëshirojnë të regjistrohen në Tregun e Energjisë Elektrike të Kosovës duhet të sigurohen sa ka në dispozicion dhe kushte teknike dhe ato janë funksionale në mënyrë që të janë në pajtueshmëri me kërkesat e komunikimit të RrT seksioni 4.1, Kodi i Matjes seksioni 8.4.4, ose Kodi i Rrjetit si mund të jetë rasti. Prandaj, pala aplikuese duhet të kontaktoj OST në mënyrë që të pranoj informatat detale për kërkesat e komunikimit për rolin e menduar në treg, përkatësisht jo më vonë se 25 ditë para nga Data Efektive.
- y) Me aderim Pala Tregtare duhet të paraqes një urdhër formal duke dorëzuar Formën e Kërkesës për Linjë të Komunikimit për OS. Kur forma e kompletuar të jetë dorëzuar nga Operatori urdhri konsiderohet si i vendosur.
- z) Me pranimin e Formën e Kërkesës për Linjë të Komunikimit Operatori paraqet një urdhër. Pjesëmarrësi pastaj do të kontaktohet nga Operatori për të diskutuar instalimin.
- aa) Pas instalimit dhe kur të përfundojnë përgatitjet për testimin kualifikuar pjesëmarrësi duhet të kontaktoj Operatorin për të diskutuar datat e preferuara të testimit.
- bb) Pas testimit të suksesshem të linjës së komunikimit por jo më vonë se 5 ditë para Datës Efektive Nga OS duhet të kontaktoj OT në mënyrë që të konfirmoj instalimin e suksesshem të linjës së komunikimit.

#### 5.5 Regjistrimi

- cc) Me pranimin e:
- (a) Marrëveshjes së Aderimit të nënshkruar si duhet nga Pjesëmarrësi i Tregut; dhe
- (b) konfirmimit për instalimin e suksesshem të linjave të komunikimit

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 12 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

OT do të kontaktoj Pjesëmarrësin e Tregut për ta këshilluar nëse aplikacioni është pranuar ose nëse nevojiten informata plotësuese për të përmbushur kërkesat e pranimit. Me pranimin OT do të nënshkruaj dhe datoj Marrëveshjen e Aderimit dhe dërgoj një kopje të Marrëveshjes tek Pjesëmarrësi i Tregut me një letër më të cilën konfirmohet kompletimi i kërkesave.


- dd) Me pranimin e kalimit të suksesshëm të të gjitha kërkesave të regjistrimit por jo më vonë se dy ditë nga Data Efektive Nga, OT do të njoftoj Palën e tillë se ajo është palë e RrT, dhe se aplikacioni i saj është në pajtim me Detalet e Palës të mbajtura nga OT në lidhje me atë palë, dhe se është në pajtim me kërkesat e paraqitura në paragrafin 0

Për më tepër OT do të:

- (a) hyjë dhe mirëmbaj të Dhënat e Regjistrimit të Palës në Regjistrin e Tregut,
- (b) përcaktoj një identitet të regjistrimit për Palën e tillë; dhe
- (c) ku Pala dëshiron ose (sipas paragrafit p)) duhet të mbaj një Llogari të Energjisë, përcaktoj një Llogari të Energjisë së Gjenerimit dhe një Llogari të Energjisë së Furnizimit për atë Palë.

- ee) Pas regjistrimit të suksesshëm të Pjesëmarrësit të Tregut, OT duhet
- (a) publikoj të dhënat vijuese për regjistrimin e suksesshëm të asaj pale në Tregun e Energjisë Elektrike në Kosovë: Datën e Regjistrimit, Kodin ETSO-EIC, Emrin e Pjesëmarrësit të Tregut, Rolin në treg
  - (b) njoftoj palën tregtare për regjistrimin e suksesshëm
  - (c) njoftoj palën tregtare për llogaritë e themeluara me sukses si kërkohet me rolin përkatës në treg.

- ff) Kur një Palë e re aderon në RrT Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) dhe të gjitha Palët Tregtare njoftohen për emrin, adresën dhe kapacitetin pjesëmarrës të Palës së re.

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 13 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

## **6. PËRMBLEDHJE: TËRHEQJA DHE ÇREGJISTRIMI I NJË PJESËMARRËSI TË TREGUT**

Sipas dispozitave për të Kapitullit III, ky kapitull definon,

1. Cilët hapa duhet të ndërmerren nga palët të cilat aplikojnë për tërheqje nga Rregullat e Tregut dhe çregjistrim nga Tregu i Energjisë Elektrike në Kosovë; përkatësisht
2. Cilat të dhëna dhe dokumente zyrtare duhet të furnizohen në cilin plan kohor;
3. Cilat autorizime nevojiten për Anulim; dhe
4. Cilat shkëmbime të të dhënave ndërmjet palëve aplikuese dhe OT janë të nevojshme për të çregjistruar si duhet palën aplikuese.

Proceset e Tërheqjes nga Tregu dhe Anulimit të paraqitura në këtë seksion janë:

- Dorëzimi i Njoftimit për Tërheqje ose pranimi i Njoftimit për Largim nga OT;
- Anulimi i Linjës së Komunikimit;
- Barazimi Përfundimtar/Kliringu Financiar;
- Çregjistrimit
- Kontrollat përfundimtare




	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 14 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

Tabela vijuese jep një përmbledhje të shkurtë të planit kohor përkatësisht Dokumentet Input dhe Output për Tërheqjen e një Pjesëmarrësit të Tregut.

Veprimet / Dokumentet	Pjesëmarrësi i Tregut D- Dërgon P=Pranon	OT D- Dërgon P-Pranon	OS D- Dërgon P-Pranon	Zyra e Rregullatorit të Energjisë D- Dërgon P-Pranon	Plani kohor Së paku x ditë para Efektive Deri me Datën
Dorëzimi i formës së plotësuar si duhet të Çregjistrimit (Tërheqjes) dhe njoftimit për tërheqje	D	P			30
Konfirmimi i pranimit të formës për Çregjistrim (Tërheqje)	P	D			25
Dorëzimi i Kërkesës për Anulim		D		P	30
Pranimi i miratimit për Anulim (ose jo)		P		D	20
Pranimi i Njoftimit për Anulim	P	D			20
Dërgimi i dëshmisë se Arsyeja për Anulim nuk ekziston (më)	D	P			10
Vendimi përfundimtar për Anulim	P	D			25
Konfirmimi i anulimit të linjës së komunikimit	D		P		25
Konfirmimi i lidhjes së komunikimit	P	P	D		20
Kontrollet përfundimtare	P	D	P		2
Konfirmimi i Kontrolleve Përfundimtare dhe	P	D	P		2, 17:00 orë

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 15 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

<b>Veprimet / Dokumentet</b>	<b>Pjesëmarrësi i Tregut</b> D- Dërgon P=Pranon	<b>OT</b> D- Dërgon P- Pranon	<b>OS</b> D- Dërgon P-Pranon	<b>Zyra e Rregullatorit të Energjisë</b> D- Dërgon P-Pranon	<b>Plani kohor</b> Së paku x ditë para Efektive Deri me Datën
Çregjistrimit					

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 16 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Spektori: Menaxhimi i Kodit</i>

## **7. PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS: TËRHEQJA E PJESËMARRËSVE TË TREGUT**

### **7.1 Dispozitat e përgjithshme**

a) Të kushtëzuar me dispozitat e tjera në këtë paragraf a) dhe përveç nëse pajtohet ndryshe Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë), nëse me kalimin e një periudhe prej 6 muajsh (ose ndonjë periudhe të zgjatur sipas paragrafit b)) pas datës efektive të aderimit të një Palë në RrT, nëse asnjë nga hapat vijues:


- (a) aplikimi për regjistrimin e Sistemit Matës;
- (b) aplikimi për regjistrimin e Njesisë Balancuese;
- (c) dorëzimi i çfarëdo Njoftimi për Kontratë të Energjisë;

Janë marr nga ose në lidhje me Palën e tillë, atëherë:

- (a) OT do të njoftoj Palën e tillë për efektin e tillë;
- (b) pala e tillë menjëherë do të pushoj të jetë Pjesëmarrëse e Tregut (dhe pushoj të jetë palë në RrT) me efekt një muaj pas datës në të cilën OT jep njoftimin e tillë dhe Pala e tillë do të trajtohet si Palë Shkëputëse dhe të jetë tërhequr nga RrT për qëllim të paragrafit 7.1.2.c).


b) Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) mundet që me aplikimin e Palës zgjasë (në një ose më shumë raste) periudhën prej 6 muajsh të referuar në paragrafin a), dhe (kur e ka zgjatur periudhën e tillë) mundet që të përcaktoj që një njoftim paraprak të jepet nga OT për Palën sipas paragrafit a) nuk do të ketë efekt.



	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 17 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

## 7.2 Tërheqja e një Pjesëmarrësi të Tregut


- c) Me kusht të Kapitullit III të RrT secila Palët (“Pala Tërheqëse”) duhet të ketë të drejtë të tërhiqet nga RrT duke e njoftuar me shkrim (“Njoftimi për Tërheqje”) OT-në dhe Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë).
- d) Njoftimi i Tërheqjes duhet të specifikoj kohën dhe datën (“Datën e Tërheqjes”) e cila nuk duhet të jetë më pak se 30 ditë pas datës së Njoftimit për Tërheqje, me efekt nga e cila Pala Tërheqëse dëshiron të tërhiqet nga RrT dhe pushoj të jetë palë e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë.
- e) Një Palë mund të mos tërhiqet nga RrT dhe çfarëdo Njoftimi për Tërheqje nuk do të ketë efekt nëse në ora 17:00 në ditën e cila është 2 Ditë Pune para Datës së Tërheqjes:
- me kusht të këtij paragrafi 7.1.2.g), të gjitha shumat e marra dhe të pagueshme sipas RrT nga Pala e tillë (qoftë ose jo të pagueshme apo qoftë ose jo objekt i një kontesti) mbesin, tërësisht ose pjesërisht të paguhen nga Pala e tillë: ose
  - Barazimi Përfundimtar nuk është kryer në lidhje me Ditën e Barazimit në të cilën Pala ka tregtuar, ose Data e Pagesës koresponduese nuk ka kaluar ende; ose
  - Përcaktimi përfundimtar (sipas Seksionit **Error! Reference source not found.**) nuk është kryer në lidhje me Tarifat e OT për vitin në të cilin Dita e Barazimit ka qenë në ditën e fundit në të cilën Pala ka tregtuar ka ra, ose data e pagesës së e shumave të pagueshme sipas përcaktimit të tillë nuk ka kaluar ende; ose
  - pala e tillë vazhdon të jetë e regjistruar sipas RrT në lidhje me çfarëdo Sistemi Matës ose Njësi Balancuese; ose
  - me kusht të paragrafit 7.1.2.g) ka një Shkelje nga Pala e tillë ( për të cilën është dhënë njoftimi Palës) e cila është e mundshme të përmirësohet dhe nuk është përmirësuar ende; ose

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 18 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

- f) Për qëllim të këtij seksioni 7 në lidhje me Palën Shkëputëse Dita e Barazimit e “fundit” është Dita përfundimtare e Barazimit në lidhje me të cilën të cilado shuma nëpërmjet Tarifave të Tregtimit mund të janë të pagueshme nga ose për Palën Shkëputëse.
- g) Në lidhje me një Palë në Tërheqje e cila ka kryer Shkelje, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) mundet që sipas diskrecionit të saj të përcaktoj se paragrafi 7.1.2.c) nuk duhet të aplikohet në lidhje me cilëndo shumë të pagueshme në bazë të Tarifës Mujore Bazë e cila paraqitet pas datës së Njoftimit për Tërheqje.
- h) Një Palë mund të pushoj të jetë Palë tregtare vetëm nëse, dhe jo më herët se data kur kushtet vijuese janë plotësuar:
- (a) nuk ka Njoftime për Kontrata të Energjisë në fuqi, në lidhje me të cilat Pala është Palë Tregtare me Kontratë, lidhur me Periudhat e Barazimit pas asaj date dhe që përmbajnë të Dhënat e Vëllimit të Kontratës për Energji me vlera jo-zero; dhe
  - (b) Pala ka anuluar të gjitha autorizimet e dhëna nën autoritetin e vet; dhe
  - (c) kur Pala pushon të jetë një Pjesëmarrës i Tregut do të mbetet përgjegjëse për çfarëdo obligime dhe do të ketë të drejtë për çfarëdo përfitimi që mundet të del për të si Pjesëmarrëse e Tregut në lidhje me çfarëdo Periudhe të Barazimit para datës së referuar në paragrafin (a) (përfshirë ato në lidhje me Tarifat e Bashkërendimit) dhe rrjedhimisht prej asaj date referencat për një Pjesëmarrës Tregu do të përfshijnë atë Palë, vetëm për atë qëllim.

### 7.3 Dorëzimi i Njoftimit për Tërheqje


- i) Palët të cilat aplikojnë të tërhiqen nga RrT duhet të dorëzojnë OT një Njoftim të Tërheqjes sipas seksionit 3.3.2 të RrT. Forma e Njoftimit të Tërheqjes mund të gjendet në Aneksin 9.1.3. Njoftimi për tërheqje duhet të nënshkruhet nga një Nënshkrues i Autorizuar sipas paragrafit 5.s)
- j) Një palë duhet t'i dorëzojë Njoftimin për Tërheqje OT nëpërmjet faksit (ose e-mailit nëse është i skenuar) jo më vonë se 30 ditë para Efektive Deri me Datën.
- k) Pala e cila tërhiqet duhet të siguroj të përmbushen kushtet për shkëputje si specifikohet në RrT, seksioni 3.3.2.
- l) OT do të kontrolloj nëse Njoftimi për Tërheqje është nënshkruar nga Nënshkruesi i Autorizuar sipas paragrafit 5.s) dhe se detalet janë të sakta.

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 19 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Spektori: Menaxhimi i Kodit</i>

- m) Pas validimit të Njoftimit për Tërheqje OT sa më parë që është e mundur por jo më vonë se 25 ditë para Efektive Deri me Datën do të konfirmoj se Njoftimi është pranuar nëpërmjet e-mailit dhe letrës.
- n) Për më shumë, OT gjithashtu do të dërgoj një e-mailin në të cilin detajohen veprimet e nevojshme që Pala të kompletoj Tërheqjen.
- o) Një Palë duhet të anuloj çfarëdo autorizimi i cili ka qenë në fuqi duke i dorëzuar format e Çregjistrimit OT (referohu Aneksit 3 Forma e Tërheqjes). Kur e specifikon Efektive Deri me Datën Pala duhet të siguroj se nuk ka njoftime për kontratë jo zero në fuqi, të cilat do të ndikonin cilëndo periudhë në ose pasuese e Efektive Deri me Datën.
- p) Fuqishëm këshillohet që një Raport i Njoftimit dhe një Raport i Autorizimit të merret nga OT për të kontrolluar nëse ka ndonjë kontratë në fuqi para anulimit të autorizimeve.


#### 7.4 Përrjashtimi i një Pale Tregtare

- q) Kur një Palë mundet të përjashtohet nga RrT sipas cilësdo dispozitë të RrT Neni 16 OT duhet të vendos (në diskrecion absolut) nëse dëshiron të përjashtoj apo jo Palën e tillë, me kusht të dispozitave tjera të paragrafit r).
- r) OT do të njoftoj Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) 10 ditë para dhënies së Njoftimit për Përrjashtim, por jo më vonë se 30 para Efektive Deri me Datën për atë Palë, dhe duhet të ketë parasysh përfaqësimet e bëra nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) dhe/ose ndonjë Palë tjetër në lidhje me këtë.
- s) OT nuk do të ketë të drejtë të përjashtoj Palën e tillë para miratimit paraprak të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE).
- t) Ku Pala që do të përjashtohet mundet të dëshmoj se arsyeja për përjashtim nuk ekziston më, kjo Palë duhet të dërgoj njoftimin me shkrim me shpjegimin detaj dhe t'i dëshmoj OT dhe ZRRrE brenda 10 dite pas pranimit të njoftimit për përjashtim.
- u) ZRRrE në bashkëpunim të ngushtë me OT brenda 5 ditëve do të vendosë nëse Pala do të përjashtohet dhe menjëherë do të njoftoj Palën për këtë vendim.
- v) Përrjashtimi i një Pale Tregtare nuk do të shlyej asnjë borxh që Pala ka ndaj OT ose Pjesëmarrësve të tjerë të Tregut, prandaj procedurat për përjashtim do të ndiqen sikur në rastin e tërheqjes


	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 20 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

## 7.5 Kontrolli i tërheqjes dhe Kliringu Financiar

- w) Me njoftimin se një Palë dëshiron të tërhiqet OT do të kontrolloj se nuk ka Konteste Tregtare që ndikojnë në Palën. Nëse identifikohen çështje, atëherë këto do të diskutohen me Palën për të përcaktuar nëse tërheqja do të ndikohet.
- x) Ku një Palë (“Pala Shkëputëse”):
- tërhiqet nga RrT dhe pushon të jetë palë e RrT sipas paragrafit c); ose
  - përrjashtohet nga RrT dhe pushon të jetë palë e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë sipas paragrafit q),
- Do të aplikohen dispozitat e paragrafit c).
- y) Me efekt nga Data e Tërheqjes ose Data e Përrjashtimit (si mund të jetë rasti) (“Data e Shkëputjes”):
- Pala Shkëputëse automatikisht do të lirohet nga të gjitha obligimet dhe detyrimet sipas RrT.
  - secila Palë tjetër me kusht të dispozitave të këtij paragrafi, automatikisht do të lirohet nga të gjitha obligimet dhe detyrimet ndaj Palës Shkëputëse sipas RrT (përrfshirë Dokumentet Ndhmëse të RrT) dhe Marrëveshjes Kornizë; dhe
  - cilatdo regjistrime dhe autorizime të bëra nga Pala Shkëputëse sipas RrT do të pushojnë të jenë efektive.
- z) Çdo lirim i referuar në paragrafin c) nuk do të jetë i zbatueshëm për:
- të drejtat dhe detyrimet (qoftë aktuale, rezerve, të krijuara ose ndryshe) të një Pale si në Datën e Shkëputjes;
  - cilatdo të drejta dhe detyrime (qoftë aktuale, rezerve, të krijuara ose ndryshe) të një Pale të cilat mund të krijohen sipas Procesit të Bashkërendimit të Barazimit ose Përcaktimit Jashtë Barazimit lidhur me ndonjë Ditë të Barazimit deri më dhe përrfshirë Ditën e Barazimit në të cilën Pala ka tregtuar;
- aa) RrT dhe Marrëveshja Kornizë duhet që me tërheqjen ose përrjashtimin (si mund të jetë rasti) të një Pale mbesin në fuqi dhe efekt, dhe obliguese për të gjitha Palët tjera.
- bb) Ku është e mundur para dhe në cilindo rast me shpejt pas tërheqjes ose përrjashtimit të Palës OT do të njoftoj:
- secilën Palë Tregtare;
  - Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë);
  - OS

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 21 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

- cc) Një Palë nuk mundet të tërhiqet nga RrT nëse:
- (a) Barazimi Përfundimtar nuk është kryer në lidhje me Ditën e Barazimit të fundit në të cilën Pala ka tregtuar, ose Data e Pagesës koresponduese nuk ka kaluar ende;
  - (b) Pala ka borxhe të mbetura (ndonjë shumë të krijuar dhe të pagueshme sipas RrT);
  - (c) Ka të regjistruara Sisteme Matëse ose Njësi Balancuese;
  - (d) Pala ka një Mos-balanc Energjetik të mbetur dhe/ose Mos-balanc Informativ pozitiv;
  - (e) Ka një Shkelje të mbetur që është e mundur të përmirësohet;
- dd) Një Palë duhet t'i dorëzoj OT formën e anulimit nëse raportet nuk janë më të nevojshme. Forma duhet të detajoj raportet të cilat Pala dëshiron t'i ndal. Nëse një Palë dëshiroj të anuloj të gjitha raportet e gjeruara atëherë në kolonën "Emri i Raportit" duhet të shkruaj "Të gjitha raportet".
- ee) Si deklarohet në paragrafin g), një Palë Tërheqëse duhet ë pastroj të gjitha borxhet e mbetura për tu tërhequr nga RrT. Me dorëzimin e Njoftimit për Tërheqje (ose gjatë diskutimeve fillestare me Palën) OT do të identifikoj nëse ka ndonjë shumë të krijuar dhe të pagueshme lidhur me Palën. Nëse ky është rasti Pala do të informohet nga OT dhe ata duhet të sigurojnë që pagesa e shumave të mbetura të pastrohet para ditës së kontrolleve përfundimtare. Kopjet e faturave mund të merren sipas kërkesës.
- ff) Në këtë pikë OT gjithashtu do të konfirmoj nëse ka ndonjë Ngarkesë të mbetur e cila duhet të pastrohet para tërheqjes. OT do të punoj së bashku me palën për të siguruar që cilatdo çështje të zgjidhen.
- gg) Nëse një Palë është në Shkelje vetëm për shkak të administratës dhe dëshiron të rikthej mbulesën e kreditit kjo mund të bëhet kur të përfundojnë kontrollet e tërheqjes. Prandaj kërkesa e Shumës Minimale të Kualifikuar duhet të dorëzohet 15 ditë para Datës së Tërheqjes së propozuar, konfirmimi i kësaj date do të jepet nga OT.
- hh) Pas përfundimit të kontrollit të tërheqjes nga OT, të gjitha Nënshkrimet e Autorizuara për palën shkëputëse do të fshihen.
- ii) Tërheqja nga RrT nuk do të lejohet nëse ngarkesat e lartpërmendura mbesin të pa paguara në ditën e kontrolleve përfundimtare.


	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 22 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

## 7.6 Anulimi i Linjës së Komunikimit

- jj) Secila Palë tërheqëse duhet të tregoj nëse dëshiron të anulojnë linjën e tyre të komunikimit duke e dorëzuar një kërkesë formale OS me postë, me fax jo më vonë se 20 ditë para Efektive Deri me Datën.
- kk) Me pranimin e njoftimit për anulim OS do të validoj kërkesën dhe kontrolloj se kërkesa për anulim është kryer saktë për Linjën e Komunikimit. Nëse ka ndonjë problem me formën pjesëmarrësi do të kontaktohet.
- ll) OS do të kontaktoj pjesëmarrësin dhe konfirmoj veprimet e mara për anulimin e shërbimit. Nëse ka ndonjë problem me anulimin pjesëmarrësi duhet të kontaktoj OS.
- mm) Brenda dy ditë të punës nga pranimi, por jo më vonë se 15 ditë para Efektive Deri me Datën, detalet e anulimit do të kalohen nga OS në OT. Pjesëmarrësi do të kontaktohet lidhur me aspektet fizike dhe komerciale të shkyçjes përfundimtare.

## 7.7 Çregjistrimi


- nn) Efektive Deri me Datën në formë mund të caktohet para Datës së Tërheqjes së propozuar dhe duhet të jetë së paku dy ditë punë në të ardhmen për të siguruar që forma të mund të procedohet me kohë.
- oo) OT validon formën duke siguruar që ajo është nënshkruar nga Nënshkruesi i Autorizuar përkatës. Pastaj OT do të kërkoj konfirmimin nga departamenti i OT se nuk ka autorizime në fuqi lidhur me DI të Palës të cilat do të ndikonin ndonjë Periudhë Barazuese pas Efektive Deri me Datën të propozuar. Pala do të kontaktohet vetëm nëse ka ndonjë problem lidhur me procesin.
- pp) Letra duhet të:
- Deklaroj se Pala pushon të Furnizoj dhe dëshiron të çregjistroj Njësitë Balancuese të ndërlidhura me emrin e tyre të Palës.
  - Konfirmoj se nuk ka më Sisteme Matëse ose të Dhëna të Mbetura të ndërlidhura me Njësitë Balancuese dhe nuk do të ketë në të ardhmen.
  - Deklaroj se Pala ka kontaktuar Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) të për të përmbushur obligimet e tyre sipas Licencës së Furnizimit.

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 23 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

- qq) Furnizuesit dhe Gjeneratorët duhet të kontaktojnë Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRÉ) për të aranzhuar tërheqjen e obligimeve sipas licencës.
- rr) Të gjithë Tregtarët Interkonektiv duhet të konsultojnë OT për të diskutuar kërkesat sipas RrT për çregjistrimin e rolit të Tregtarit Interkonektiv.
- ss) Të gjithë gjeneratorët duhet të respektojnë dispozitat e procedurës operative K002: Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Njësive Balancuese në mënyrë që të çregjistrojnë ndonjë Njësi Balancuese përkatësisht procedurën operative ET002 Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemeve Matëse në mënyrë që të çregjistrojnë Sistemet Matëse. OT duhet të kontaktohet gjatë fazave fillestare të procesit në mënyrë që të mund të jepet ndihma.
- tt) Të gjithë furnizuesit duhet të respektojnë dispozitat e procedurës operative ET002 Regjistrimi dhe Çregjistrimi i Sistemeve Matëse në mënyrë që të çregjistrojnë Sistemet Matëse të tyre. OT duhet të kontaktohet gjatë fazave fillestare të procesit në mënyrë që të mund të jepet ndihma.


### 7.8 Kontrollat Përfundimtare

- uu) OT do të kryej kontrollat përfundimtare dy Ditë Pune para Datës së Tërheqjes për të siguruar se janë përmbushur të gjitha kriteret e tërheqjes.
- vv) OT do të kryej kontrollat përfundimtare vijuese në pajtim me RrT Neni 16 si në ora 5 pas dite dy Ditë Puna para Datës së Tërheqjes së propozuar:
- (a) Kontrollon me OT dhe OS se të gjitha autorizimet, rolet e Palës, Njësitë Balancuese dhe Sistemet Matëse lidhur me DI të Palës janë çregjistruar.
  - (b) Kontrollon se Data e Pagesës lidhur me ditën e fundit të tregtimit për Palën ka kaluar.
  - (c) Konfirmoj se të gjitha Ngarkesat në lidhje me RrT që kanë të bëjnë me DI të Palës janë pastruar.

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 24 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>


- ww) Nëse është e aplikueshme OT do të konfirmoj se Pala është në Shkelje vetëm për shkak të administratës.
- xx) Nëse kontrollet e lartpërmendura janë përmbushur OT do t'i konfirmoj Palës me e-mail ose letër Datën e Tërheqjes përfundimtare.
- yy) Ku kontrollet e lartpërmendura dështojnë dhe çështjet e mbetura janë identifikuar Pala nuk do të lejohet të tërhiqet dhe menjëherë do të pranoj një njoftim nga OT.
- zz) Njoftimi për dështimin e kalimit të kontrolleve do të jepet nëpërmjet e-mailit dhe letrës, atëherë Pala duhet të ridorëzoj një Njoftim të Tërheqjes dhe përsëri përcjellë procesin.
- aaa) Pas kontrollit të suksesshëm përfundimtar OT do të
- (a) publikoj të dhënat vijuese lidhur me tërheqjen e asaj pale nga Tregu i Energjisë Elektrike në Kosovë: Datën e Çregjistrimit, EIC, Emrin e Palës, Rolin në treg.
  - (b) njoftoj Palën për çregjistrimin e suksesshëm; dhe
  - (c) njoftoj Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) për çregjistrimin e suksesshëm të asaj pale ose rolit të palës përkatësisht.



	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 25 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

## **8. PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS: NDRYSHIMI I TË DHËNAVE KRYESORE OSE ROLIT TË PALËS**

- a) Pa paragjykim në përgjithësimin e paragrafit 5.p), nëse në çfarëdo kohe:
- (a) një Palë dëshiron të ndryshoj ndonjë nga detajet e veta kontaktuese të cilat përbëjnë pjesë të Detajeve të Palës së tillë; ose
  - (b) ka apo do të ketë ndonjë ndryshim në kapacitetet pjesëmarrëse të një Pale; ose
  - (c) Detalet e Palës të një Pale ndryshe për çfarëdo arsye pushojnë të janë të sakta dhe komplete në të gjitha aspektet materiale;
- Pala e tillë do të njoftoj OT sa më parë që është arsyeshëm praktike para ndryshimit të tillë dhe duhet të ofroj ato informata plotësuese dhe dokumentacion mbështetës si mund të kërkoj arsyeshëm OT për të evidentuar ndryshimin e tillë.
- b) Pa paragjykim ndaj paragrafit a), çfarëdo e-mail adrese plotësuese e dorëzuar nga një Palë për qëllim të pranimit të njoftimeve ose komunikimeve në lidhje me çështjet e parashtruara në RrT ose këto Procedura të Regjistrimit duhet të përbëjnë pjesë të Detaleve të Palës të asaj Pale.
- c) Nëse në çfarëdo kohe:
- (a) ka ndonjë ndryshim në kapacitetet pjesëmarrëse të një Pale;
  - (b) të Dhënat e Regjistrimit të Palës të një pale ndryshe për çfarëdo arsye pushojnë të janë të sakta dhe komplete në të gjitha aspektet materiale.
- d) Me pranimin e një aplikacioni sipas paragrafit a) dhe me kusht të konfirmimit nga OT se informatat e përmbajtura në aplikacionin e tillë janë në përputhje me Detalet e Palës të mbajtura nga OT në lidhje me atë Palë, OT do të përmirësoj të Dhënat e Regjistrimit të Palës të mirëmbajtura në Regjistrin e Tregut për të reflektuar ndryshimet e përcaktuara në aplikacionin e tillë;
- e) Ku Pala dëshiron ose duhet të bëhet një Pjesëmarrës i Tregut, përcjell dispozitat në seksionin 0
- f) Ku një Palë dëshiron të pushoj të jetë Palë Tregtare përcjell dispozitat e seksionit 0.

	Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg	PR-MO-002
	ver. 1.0	page 26 from 30
Departament: Operimi i Tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

## 9. ANEKSET

### 9.1.1. Aneksi 1: Marrëveshja Kornizë apo e Aderimit


Shih anekset e Rregullave të Tregut

### 9.1.2. Aneksi 2: Shembulli i Formës së Regjistrimit

#### Forma e Regjistrimit për Procedurën Operative ET001

Ju lutem kompletini formën dhe dërgojeni në KOSTT: Ndërtesa e KOSTT, rruga Iljaz Kodra pn Prishtinë, Kosovë

Ref	Kërkesat për informata	Detalet e Palës
A	Emri i plotë ligjor	
B	Detalet kontaktuese Emri, adresa, numri i faksit Numri i telefonit dhe e-maili, Adresa e personit për vëmendjen e të cilit duhet të shënohen njoftimet	Emri Adresa Faksi Nr Tel E-maili
C	Ju lutem paraqitni këtu Nr. e Licencës së ZRrE	
D	Adresa në Kosovë për shërbimet e procesit në emër të tij për ndonjë veprim	
E	Roli/Kapaciteti i Tregut në të cilin dëshironi të bashkoheni (ju lutem shënoni kutinë përkatëse	Gjenerator Furnizues Tregtar jo fizik Tregtar interkonektiv Kompani distributive
F	Emëro ndonjë Pjesëmarrës ekzistues të Tregut i cili është i Ndërvartës i Palës Aplikuese	
H	Ju lutem paraqitni numrin tuaj të regjistrimit për TVSH	


	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 27 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

	dhe regjistrimin e TVSH të shtetit	
--	------------------------------------	--

Ne deklarojmë se Detalet e Palës të Pjesëmarrësit të Tregut të (paraqit emrin e plotë ligjor të kompanisë) të paraqitura janë complete dhe të sakta.

Nënshkruar: \_\_\_\_\_ në emër të Pjesëmarrësit të Tregut (paraqit emrin e plotë ligjor të kompanisë)

Emri \_\_\_\_\_

	<b>Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg</b>	<b>PR-MO-002</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 28 from 30</i>
<i>Departament: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Menaxhimi i Kodit</i>

### 9.1.3. Aneksi 3: Shembulli i Formës së Njoftimit të Tërheqjes

#### Forma e Tërheqjes për Procedurën Operative ET001

Ju lutem kompletioni formën dhe dërgojeni në KOSTT: Ndërtesa e KOSTT, rruga Iljaz Kodra pn Prishtinë, Kosovë


Ref	Kërkesat për informata	Detalet e Palës
A	Emri i plotë ligjor	
B	Detalet kontaktuese Emri, adresa, numri i faksit Numri i telefonit dhe e-maili, Adresa e personit për vëmendjen e të cilit duhet të shënohen njoftimet	Adresa Faksi Nr Tel E-maili
C	Ju lutem paraqitni këtu Nr. e Licencës së ZRrE	
D	Adresa në Kosovë për shërbimet e procesit në emër të tij për ndonjë veprim	
E	Roli/Kapaciteti i Tregut në të cilin dëshironi të tërhiqeni	Gjenerator Furnizues Tregtar jo fizik Tregtar interkonektiv Kompani distributive
F	Emëro ndonjë Pjesëmarrës ekzistues të Tregut i cili është i Ndërvartës i Palës Aplikuese	
G	Data e menduar e tërheqjes	

Ne deklarojmë se Detalet e Palës të Pjesëmarrësit të Tregut të (paraqit emrin e plotë ligjor të kompanisë) të paraqitura janë komplete dhe të sakta.

Nënshkruar: \_\_\_\_\_ në emër të Pjesëmarrësit të Tregut (paraqit emrin e plotë ligjor të kompanisë)

Emri \_\_\_\_\_

Titulli \_\_\_\_\_

	Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve në treg	PR-MO-002
	ver. 1.0	page 29 from 30
Departament: Operimi i Tregut		Sektori: Menaxhimi i Kodit

Data \_\_\_\_\_

## 10. DOKUMENTET/FORMULARËT

### Burimet

Nr.	Emri i dokumentit
1	Rregullat e Tregut

### Dokumentet/formularët

- Forma e Regjistrimit
- Forma e Çregjistrimit

### Shënimet për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohëruajtja
1.0	Janar 2008	Verzioni inicial	5 vite



Regjistrimi dhe Tërheqja e palëve  
në treg

PR-MO-002

*ver. 1.0*

*page 30 from 30*

*Departament: Operimi i Tregut*

*Sektori: Menaxhimi i Kodit*